



Raporti i Performancës

Bashkia Divjakë

2025



Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Përgatitja teknike e këtij botimi u mbështet nga Smart Processes, në kuadër të asistencës teknike të ofruar për bashkitë nga projekti "Bashki të Forta"



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS



Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	4
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	5
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	6
Kategoria: Shërbimet	7
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	8
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	15
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	19
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	28
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	35
Menaxhimi i mbetjeve	40
Përkujdesi Social	46
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime.....	50
Shërbimet Publike Vendore	55
Rrjeti rrugor rural	62
Planifikimi Urban Vendor.....	65
Policia bashkiake.....	71
Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve.....	74
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	76
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	79
Sport dhe argëtim	81
Kategoria: Mirëqeverisja	84
Burimet Njerëzore	85
Kategoria: Menaxhimi Financiar	86
Të Ardhurat.....	87
Buxheti.....	89
Shpenzime.....	91



Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”, i cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky proces reformash, i shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji “Për financat vendore” (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale.

Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi i performancës në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura përmes një procesi konsultues me ekspertë tematikë



Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Bashkia Divjakë është një nga njësitë vendore në qarkun e Fierit, e karakterizuar nga një pozicion gjeografik strategjik dhe një potencial të konsiderueshëm natyror, ekonomik dhe turistik. Me një sipërfaqe prej rreth 309 km², bashkia përfshin pesë njësi administrative: Divjakë, Gradishtë, Grabian, Remas dhe Tërbuf, me qendrën administrative në qytetin e Divjakës. Popullsia e Bashkisë llogaritet të jetë rreth 34,000 banorë, të shpërndarë në zona urbane dhe rurale. Ekonomia lokale bazohet kryesisht në bujqësi, blegtori dhe aktivitetet agroturistike, ndërsa vitet e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme të interesit për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, falë Parkut Kombëtar të Divjakë-Karavastasë – një nga zonat më të rëndësishme të biodiversitetit në Shqipëri dhe në rajon. Bashkia është e përkushtuar ndaj zhvillimit të infrastrukturës, përmirësimit të shërbimeve publike dhe nxitjes së pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse. Përmes bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Divjaka synon të shndërrohet në një model të zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.



Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

Sipas të dhënave zyrtare, popullsia e Bashkisë Divjakë në vitin 2020 ishte rreth **34,200 banorë**. Gjatë periudhës 2020–2024, është vërejtur një tendencë e lehtë në rënie, e ndikuar kryesisht nga emigracioni dhe lëvizja e brendshme e popullsisë drejt zonave urbane më të mëdha. Në vitin 2024, popullsia vlerësohet të jetë rreth **32,800 banorë**.



Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.

Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.



Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015, i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik, kopshtet. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financiar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit. Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore, dhe raporti fëmijë-mësues.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	0	10.57	10.73	10.73	10.73	10.73
Mësimi në klasat e arsimit bazë zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë	0	17.21	15.56	15.1	15.1	15.1
Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor	Raporti në % i numrit të fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve 3 - 6 vjeç	0	100	100	100	100	97
Rritja e ndergjegjesimit ne lidhje me rendesine e kopshtit	Raporti I kopshteve ku jane ngritur këshillat e prinderve kundrejt numrit total te kopshteve (ne %)	0	6.25	6.25	6.25	6.25	6.25



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i fëmijëve vajza të moshës 3 - 6 vjeç rezidente në territorin e bashkisë	numër	386	379	384	356	349	326
Nxënëse femra të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	numër		1,417	1,357	1,244	1,145	1,064
Numri i fëmijëve vajza të regjistruara në sistemin parashkollor	numër		362	240	356	349	326
Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç rezident në territorin e bashkisë	numër	785	786	739	712	698	662
Staf mbështetës në arsimin bazë	numër		79	81	80	82	82
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	numër		3,064	2,909	2,698	2,497	2,297
Numri total i godinave të kopshteve	numër	32	32	32	32	31	31
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar) Meshkuj	numër		1,647	1,552	1,454	1,352	1,233
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç Meshkuj	numër	399	407	355	356	349	336
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç Meshkuj	numër	53	58	57	52	58	62
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç Femra	numër	59	60	51	64	65	56
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	numër	112	118	108	116	123	118




Numri i fëmijëve djem të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	399	407	355	356	349	336
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor	numër	48	45	33	47	47	46
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit bazë	numër		290	271	350	350	367
Klasa në sistemin parashkollor	numër	44	44	44	43	43	41
Klasa në sistemin e arsimit bazë	numër		178	187	210	201	193
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	785	786	739	712	698	662
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë	lekë		79,857,930	87,194,040	100,891,000	111,052,000	113,976,232
Numri i nxënësve që përfitojnë nga aktivitetet e Q. K. F	numër	105	100	100	95	95	90
Numri i kopshteve ku është ngritur bordi i kopshtit	numër		2	2	10	10	10
Numri i kopshteve ku është ngritur këshilli i prindërve	numër	13	13	13	13	14	14
Aktivite sensibilizuese për rëndësinë e shkollës dhe arsimit parashkollor	numër		5	6	3	3	3
Edukatorë të kualifikuar/trajnuar	numër	47	47	47	47	46	46



Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar

Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin 9-vjeçar ka pësuar një rënie nga 3064 nxënës në vitin 2021 në 2909 nxënës në vitin 2022. Kjo përfaqëson një ulje prej rreth 5.1%, duke reflektuar ndikimin e faktorëve demografikë dhe socialë që kanë ndikuar në zvogëlimin e numrit të fëmijëve në moshë shkollore. Rënia e numrit të regjistrimeve lidhet kryesisht me migrimin e familjeve drejt zonave urbane, si dhe me uljen e lindshmërisë gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, lëvizjet demografike kanë ndikuar në shpërndarjen e popullsisë, duke sjellë ulje të numrit të nxënësve në disa zona. Megjithatë pavarësisht kësaj tendence në rënie, sistemi arsimor ka vijuar të ofrojë shërbime arsimore dhe të ruajë vazhdimësinë e procesit mësimor. Në vitet në vazhdim synohet forcimi i cilësisë së arsimit, krijimi i kushteve më të mira për nxënësit dhe rritja e bashkëpunimit me komunitetin dhe prindërit, me qëllim përmirësimin e frekuentimit dhe motivimit të nxënësve.




Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor

Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor ka paraqitur luhatje gjatë periudhës 2020–2025. Në vitin 2020 numëroheshin 48 mësues, ndërsa në vitin 2025 ky numër rezulton 46 mësues, duke shënuar një ulje të lehtë prej rreth 4.2%. Gjatë viteve 2021 dhe veçanërisht 2022 është evidentuar një rënie më e ndjeshme e numrit të mësuesve, ku nga 45 mësues në vitin 2021, numri zbriti në 33 në vitin 2022. Kjo ulje mund të jetë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si lëvizjet e stafit, daljet në pension. Ndërkohë, në vitin 2023 vihet re një rikuperim i konsiderueshëm, me rritje në 47 mësues, çka tregon përpjekjet për stabilizimin e stafit dhe plotësimin e nevojave të institucioneve parashkollore. Në vitet 2024 dhe 2025 numri i mësuesve ka mbetur pothuajse i




qëndrueshëm, duke reflektuar një stabilitet më të madh në menaxhimin e burimeve njerëzore në këtë sektor. Ruajtja e një niveli të qëndrueshëm të stafit pedagogjik mbetet e rëndësishme për garantimin e cilësisë së edukimit në arsimin parashkollor. Në vijim do të synohet forcimi i kapaciteteve profesionale të mësuesve, përmirësimi i kushteve të punës dhe krijimi i mundësive për zhvillim profesional të vazhdueshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit edukativ për fëmijët.



Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor


Në Bashkinë Divjakë, numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor ka shënuar një rënie graduale gjatë periudhës 2020–2025. Në vitin 2020 ishin të regjistruar 785 fëmijë, ndërsa në vitin 2025 numri ka zbritur në 662 fëmijë, duke reflektuar një ulje prej rreth 15.7%. Gjatë viteve 2020 dhe 2021 numri i fëmijëve ka mbetur pothuajse i pandryshuar, por nga viti 2022 e në vijim vihet re një tendencë e vazhdueshme në ulje. Kjo situatë lidhet kryesisht me faktorë demografikë, si ulja e lindshmërisë, migrimi i familjeve drejt qyteteve më të mëdha. Megjithatë, Bashkia Divjakë dhe institucionet arsimore kanë vijuar të ofrojnë shërbime edukative për fëmijët, duke synuar ruajtjen e standardeve të edukimit dhe përmirësimin e kushteve në institucionet parashkollore. Pavarësisht rënies së numrit të regjistrimeve, mbetet prioritet rritja e cilësisë së shërbimit, krijimi i ambienteve më të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve dhe mbështetja e stafit edukativ. Në vitet në vazhdim synohet forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe prindërit, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit parashkollor dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve pedagogjike, me qëllim garantimin e një edukimi sa më cilësor për çdo fëmijë.





Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve dhe ndërtesave të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke përfshirë shkollat profesionale, si dhe shpenzimet për pagat e stafit mbështetës. Kjo përfshin gjithashtu administrimin, organizimin e inspektimit të shërbimeve në konvikte, për strehimin dhe ofrimin e vateve ushqimore për nxënësit.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	0	23.56	23.17	23	19	19
Rritja e efikasitetit buxhetor për përmirësimin e shërbimit arsimor të mesëm	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit të mesëm të përgjithshëm kundrejt numrit total të nxënësve të arsimit të mesëm të përgjithshëm (leke/nxenes)	0	1,060.13	91,783.2	1,060.13	1,060.00	1,060.00



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matëse	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Total shpenzime për institucionin e arsimit të mesëm	lekë		1,073,910	87,194,040	100,891	111,052	124,143
Nxënëse femra të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	numër		547	499	466	428	396
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9 vjeçar)	numër		367	304	339	296	272
Staf mbështetës në sistemin e arsimit të mesëm	numër	5	5	10	4	4	9
Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	numër		1,013	950	845	781	724
Nxënës të regjistruar në sistemin e mesëm arsimor (viti 10-12) Meshkuj	numër		466	451	845	781	724
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm	numër		92	95	79	76	81
Klasa në sistemin e arsimit të mesëm	numër		43	41	36	36	35
Numri i nxënësve që përfitojnë bursë	numër			8	10	10	10



Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm

Në Bashkinë Divjakë, numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm ka shënuar një rënie të vazhdueshme gjatë periudhës 2021–2025. Nga 1013 nxënës të regjistruar në vitin 2021, numri ka zbritur në 724 nxënës në vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej rreth 28.5%. Rënia më e ndjeshme është evidentuar pas vitit 2022, ku numri i nxënësve ka vijuar të ulet gradualisht nga 845 në vitin 2023, në 781 në vitin 2024 dhe 724 në vitin 2025. Kjo tendencë lidhet kryesisht me faktorët demografikë, uljen e numrit të lindjeve dhe lëvizjen e të rinjve drejt zonave më të mëdha urbane për arsye arsimimi apo ekonomike. Gjithashtu, një pjesë e nxënësve mund të kenë zgjedhur arsimin profesional ose alternativa të tjera edukimi jashtë territorit të bashkisë, duke ndikuar në uljen e regjistrimeve në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Megjithatë, institucionet arsimore në Bashkinë Divjakë kanë vijuar të garantojnë zhvillimin normal të procesit mësimor dhe ofrimin e shërbimeve arsimore për nxënësit. Në vijim synohet përmirësimi i cilësisë së arsimit, forcimi i kushteve infrastrukturore dhe krijimi i mundësive më të mira për zhvillimin akademik dhe profesional të të rinjve. Fokus i veçantë do të mbetet rritja e motivimit të nxënësve për ndjekjen e arsimit të mesëm, bashkëpunimi me familjet dhe komunitetin, si dhe mbështetja e programeve që ndihmojnë në uljen e braktisjes shkollore dhe rritjen e përfshirjes në arsim.





Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shërbimi i ujitje-kullimit përfshin mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore u transferua bashkive në vitin 2016. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Përmirësimi i rrjetit ujitës	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	0	69.83	74.81	2.53	3	11.9
Përmirësim i rrjetit kullues	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	0	80.28	80.28	16.2	14.18	15.1
Rritja e numrit të familjeve fermere përfituese	Numri i familjeve përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit, ndryshimi vjetor në numër	0	0	0	6,500	6,700	6,800
Rritje e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me ujitje	Sipërfaqe bujqësore në Ha e mbuluar me ujitje (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar)	9,000	9,000	9,000	9,000	9,000	9,000
Rritje e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me kullim	Sipërfaqe bujqësore në Ha e mbuluar me kullim (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar)	7,000	8,000	9,000	10,000	11,000	12,000
Kultivimi i tokës bujqësore	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të kultivuar ndaj sipërfaqes totale bujqësore	0	77.75	87.06	87.06	87.06	87.06
Rritja e efikasitetit buxhetore	Shpenzime për pastrim dhe mirëmbajtje të rrjetit ujitës dhe kullues, kundrejt totalit të rrjetit të pastruar dhe mirëmbajtur (lekë/km)	0	262,333.33	379,631.58	361,911.72	379,410.34	326,478.13




Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- **Përmirësimi i rrjetit ujitës**

Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)

□ Në Bashkinë Divjakë, treguesi i përmirësimit të rrjetit ujitës, i matur si përqindje e kanaleve vaditëse të pastruara kundrejt rrjetit total në pronësi të bashkisë, ka shfaqur luhatje të theksuara gjatë periudhës 2020–2025. Në vitin 2020 nuk është raportuar ndërhyrje në pastrimin e kanaleve vaditëse (0%), ndërsa në vitin 2021 vihet re një përmirësim shumë i ndjeshëm, ku rreth 69.83% e rrjetit është pastruar. Ky trend pozitiv vazhdon edhe në vitin 2022, duke arritur kulmin me 74.81%, çka tregon një angazhim të lartë në mirëmbajtjen e infrastrukturës ujitëse dhe një fokus të shtuar në mbështetjen e sektorit bujqësor. Megjithatë, pas këtij përmirësimi të ndjeshëm, në vitet pasuese vihet re një rënie drastike e ndërhyrjeve, ku në vitin 2023 niveli bie në 2.53%, në vitin 2024 në 3%, dhe në vitin 2025 në 11.9%. Kjo ulje mund të lidhet me mungesë investimesh të qëndrueshme, prioritetet e ndryshuara buxhetore, ose kalimin nga ndërhyrje masive në mirëmbajtje më të kufizuar dhe të pjesshme të rrjetit. Në përgjithësi, dinamika tregon një fazë fillestare shumë aktive në rehabilitimin e kanaleve ujitëse, e ndjekur nga një periudhë me intensitet më të ulët të punimeve, që mund të ketë ndikuar në efciencën e sistemit vaditës për sektorin bujqësor. Në të ardhmen, synojmë një plan më të qëndrueshëm mirëmbajtjeje, me ndërhyrje të rregullta çdo vit, rritje të financimeve të dedikuara dhe koordinim më të mirë me fermerët dhe strukturat e menaxhimit të ujit. Kjo do të ndihmonte në stabilizimin e sistemit vaditës dhe rritjen e produktivitetit bujqësor në zonë.






• Përmirësim i rrjetit kullues

Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)

Në Bashkinë Divjakë, treguesi i përmirësimit të rrjetit kullues, i matur si përqindje e kanaleve kulluese të pastruara kundrejt rrjetit total në pronësi të bashkisë, paraqet një ecuri me dy faza të dallueshme gjatë periudhës 2020–2025. Në fillim të periudhës (2020), nuk raportohet ndërhyrje në pastrimin e kanaleve kulluese (0%). Më pas, në vitet 2021 dhe 2022 vihet re një rritje shumë e fortë dhe e menjëhershme e performancës, duke arritur në 80.28%. Kjo tregon një fazë intensive ndërhyrjesh infrastrukturore, ku është realizuar një pastrim i gjerë i rrjetit kullues, me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e menaxhimit të ujërave dhe mbrojtjen e tokave bujqësore nga përmytjet. Pas kësaj faze kulmore, vihet re një rënie e ndjeshme e intensitetit të ndërhyrjeve në vitet në vijim. Në vitin 2023 niveli zbret në 16.2%, në vitin 2024 në 14.18%, ndërsa në vitin 2025 ka një stabilizim të lehtë në 15.1%. Kjo tregon kalimin nga një fazë rehabilitimi masiv në një fazë mirëmbajtjeje më të kufizuar dhe periodike të rrjetit kullues. Në përgjithësi, dinamika e këtij treguesi tregon se infrastruktura kulluese është përmirësuar ndjeshëm në një periudhë të shkurtër kohe, por ruajtja e funksionalitetit të saj kërkon ndërhyrje të vazhdueshme dhe të planifikuara. Në vijim, do jetë në focus krijimi i një sistemi mirëmbajtjeje të qëndrueshme vjetore, në mënyrë që të shmanget degradimi i rrjetit dhe të sigurohet funksionim i rregullt i tij, veçanërisht në periudhat me reshje të larta dhe rrezik për përmytje.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shpenzime për pastrim dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues në lekë	lekë		29,906,000	36,065,000	29,227,991	28,140,865	36,026,862
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	km		401	401	401	401	401
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	km		436	436	436	436	436
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	ha		20,460	20,460	20,460	20,460	20,460
Numri i stafit i angazhuar për shërbimin	numër		25	25	25	25	25
Shpenzimet për investime të programit ujitje kullimi	lekë	41,861,030	0	3,546,680	6,268,366	50,132,911.44	14,477,961,000
Kanale ujitëse dhe kullues të pastruar/mirëmbajtur (në km)	km		114	95	80.76	74.17	110.35
Sipërfaqe e tokës bujqësore e kultivuar (në ha)	ha		15,907	17,813	17,820	17,820	17,820
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	ha		6,500	8,500	8,500	8,500	8,500
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	ha		16,800	16,817	16,820	16,820	16,820
Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km	km		350	350	70.6	61.83	65.86




Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	km		280	300	10.16	12.33	44.49
Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	numër		6,800	7,000	7,000	7,000	7,000



Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km

Në Bashkinë Divjakë, treguesi i rrjetit kullues të mirëmbajtur/pastruar (në km) tregon një ecuri me ndryshim të fortë struktural gjatë periudhës 2021–2025. Në dy vitet e para të raportuara (2021 dhe 2022), gjendja paraqitet plotësisht e qëndrueshme me 350 km rrjet të pastruar në secilin vit, duke reflektuar një fazë intensive ndërhyrjeje dhe një nivel të lartë mbulimi të sistemit kullues. Megjithatë, nga viti 2023 vihet re një rënie shumë e theksuar në 70.6 km, që përfaqëson një ulje prej rreth 79.8% krahasuar me nivelin e mëparshëm. Kjo ndryshesë e madhe sugjeron ose ndryshim metodologjike në raportim, ose reduktim të ndjeshëm të ndërhyrjeve të mirëmbajtjes, ose fokusim vetëm në segmentet prioritare të rrjetit. Në vitin 2024 tendenca vijon me një ulje të mëtejshme në 61.83 km (rreth -12.4% krahasuar me 2023), duke treguar një fazë më të kufizuar të ndërhyrjeve. Ndërkohë, në vitin 2025 vihet re një rikuperim i lehtë në 65.86 km (+6.5%), që mund të sinjalizojë rifillim të pjesshëm të aktiviteteve të mirëmbajtjes. Në përgjithësi, dinamika e këtij treguesi tregon kalim nga një fazë me ndërhyrje të plota dhe të gjera në fillim të periudhës, drejt një faze më selektive dhe me kapacitet më të ulët ndërhyrjeje në vitet pasuese. Në të ardhmen, fokus do jetë stabilizimi i këtij treguesi përmes një programi të qëndrueshëm mirëmbajtjeje vjetore, në mënyrë që të shmangët degradimi i rrjetit dhe të ruhet funksionaliteti i tij në të gjithë territorin.




Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km

Në Bashkinë Divjakë, treguesi i rrjetit ujitës të mirëmbajtur/pastruar (në km) paraqet një dinamikë me luhate të forta gjatë periudhës 2021–2025, duke reflektuar ndryshime të rëndësishme në intensitetin e ndërhyrjeve në infrastrukturën ujitëse. Në vitet 2021 dhe 2022 vihet re një nivel



relativisht i lartë mirëmbajtjeje, përkatësisht 280 km dhe 300 km, çka tregon një fazë aktive ndërhyrjesh dhe përpjekje për përmirësimin e rrjetit ujitës, me ndikim të drejtpërdrejtë në mbështetjen e aktivitetit bujqësor në zonë. Megjithatë, nga viti 2023 ndodh një ndryshim i menjëhershëm dhe i thellë në trend, ku rrjeti i mirëmbajtur bie në 10.16 km, duke shënuar një reduktim shumë të madh krahasuar me vitet paraardhëse. Në vitin 2024 vihet re një rritje e lehtë në 12.33 km, ndërsa në vitin 2025 ka një përmirësim më të ndjeshëm duke arritur në 44.49 km, që tregon një rikthim të pjesshëm të ndërhyrjeve dhe një rritje të kapaciteteve të mirëmbajtjes. Në tërësi, kjo ecuri tregon një kalim nga një fazë intensive investimesh dhe pastrimesh në fillim të periudhës, drejt një periudhe me reduktim të ndjeshëm të aktivitetit, e ndjekur së fundmi nga shenja rikuperimi. Në vijim, Bashkia Divjakë do të synojë stabilizimin e ndërhyrjeve në rrjetin ujitës përmes një planifikimi më afatgjatë, duke garantuar mirëmbajtje të vazhdueshme çdo vit, në mënyrë që të shmangen luhatjet e mëdha dhe të sigurohet funksionim i qëndrueshëm i sistemit për nevojat e bujqësisë lokale.




Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit

Në Bashkinë Divjakë, numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit paraqet një tendencë të qëndrueshme gjatë periudhës 2021–2025, me një stabilizim të qartë pas vitit të parë të raportuar. Në vitin 2021, numri i familjeve përfituese ishte 6800, ndërsa në vitin 2022 vihet re një rritje në 7000 familje, që përfaqëson një zgjerim prej rreth 2.9%. Kjo rritje tregon përmirësim të mbulimit të shërbimeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe përfshirje më të gjerë të fermerëve në sistemin ekzistues. Nga viti 2022 deri në vitin 2025, numri mbetet i pandryshuar në 7000 familje, duke reflektuar një stabilitet të plotë të shërbimit dhe një mbulim të konsoliduar të zonës bujqësore. Ky qëndrueshmëri tregon se sistemi i ujitjes dhe kullimit ka arritur një nivel



maksimal mbulimi, ku pothuajse e gjithë baza e mundshme e familjeve fermere është e përfshirë në shërbim. Megjithatë, fakti që numri nuk rritet më tej mund të sugjerojë se sfida e ardhshme nuk është zgjerimi i mbulimit, por përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit ekzistues. Në këtë drejtim, Bashkia Divjake do të fokusohet në modernizimin e infrastrukturës, përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe rritjen e efikasitetit të shpërndarjes së ujit për vaditje.

Në të ardhmen, prioritet mbetet jo vetëm ruajtja e këtij niveli të mbulimit, por edhe rritja e cilësisë së shërbimit për të mbështetur më mirë produktivitetin bujqësor dhe qëndrueshmërinë e sektorit rural.





Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe afim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimit e shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e licencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrolle të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor	Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota	0	132.63	140.43	150	152	155
Rritja e efikasitetit buxhetor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)	0	124,220,000	210,846,000	136,230,408	128,235,219	145,635,090




Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- **Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullor**

Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota

Në Bashkinë Divjakë, treguesi i rritjes së inspektimeve të fondit pyjor dhe kullor (numri i kontrolleve për 1000 ha pyje dhe kullota) paraqet një trend të qartë rritës dhe të qëndrueshëm gjatë periudhës 2020–2025. Në vitin 2020 nuk raportohet aktiviteti i inspektimit (0), ndërsa në vitin 2021 vihet re një rritje e ndjeshme në 132.63 kontrolle për 1000 ha, duke shënuar fillimin e një qasjeje më aktive në monitorimin e fondit pyjor dhe kullor. Ky përmirësim vazhdon edhe në vitin 2022, ku treguesi rritet në 140.43, duke reflektuar forcim të kapaciteteve të kontrollit dhe rritje të vëmendjes institucionale ndaj menaxhimit të burimeve natyrore. Nga viti 2023 e në vijim, trendi bëhet më i qëndrueshëm dhe gradualisht në rritje: 150 në 2023, 152 në 2024 dhe 155 në 2025. Kjo tregon konsolidim të sistemit të inspektimit dhe kalim nga një fazë nisjeje në një fazë stabiliteti dhe monitorimi të vazhdueshëm. Në përgjithësi, kjo ecuri pasqyron përmirësim të dukshëm në qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor në Bashkinë Divjakë, duke ulur rrezikun e abuzimeve dhe duke rritur kontrollin mbi përdorimin e burimeve natyrore. Në vijim, prioritet mbetet jo vetëm ruajtja e këtij niveli kontrolli, por edhe forcimi i cilësisë së inspektimeve, rritja e përdorimit të teknologjisë në monitorim dhe bashkëpunimi me komunitetin lokal për një menaxhim më të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.






- **Rritja e efijencës buxhetore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor**

Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)

Në Bashkinë Divjakë, treguesi i efijencës buxhetore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor (shpenzime për 1 ha pyje dhe kullota) paraqet një ecuri me luhatje të theksuara gjatë periudhës 2020–2025, duke reflektuar ndryshime si në nivelin e financimit ashtu edhe në mënyrën e organizimit të shërbimit .Në vitet e para të raportuara (2021 dhe 2022), vlera e shpenzimeve për 1 ha rritet nga 1242.2 në 2108.46 lekë, duke treguar një intensifikim të investimeve dhe një rritje të kostos së menaxhimit të fondit pyjor dhe kullor. Kjo mund të lidhet me zgjerimin e aktiviteteve të inspektimit, rritjen e ndërhyrjeve në terren dhe përmirësimin e strukturave të monitorimit. Nga viti 2023 vihet re një ndryshim i ndjeshëm në mënyrën e raportimit dhe në shkallën e shpenzimeve totale, ku vlerat kalojnë në nivele shumë më të larta nominale (136,230,408 lekë), të ndjekura nga 128,235,219 lekë në 2024 dhe 145,635,090 lekë në 2025. Kjo tregon një fazë me financim më të madh total për menaxhimin e fondit, por jo domosdoshmërisht rritje lineare të efijencës për njësi sipërfaqeje, pasi struktura e shpenzimeve duket e ndikuar nga faktorë buxhetorë dhe operativë më kompleksë.Në përgjithësi, dinamika e këtij treguesi sugjeron një kalim nga një fazë me shpenzime më të moderuara dhe të llogaritura për njësi sipërfaqeje, drejt një faze me financim më të lartë total, që mund të jetë shoqëruar me zgjerim aktivitetesh, rritje të kostove të mirëmbajtjes dhe forcim të kapaciteteve menaxhuese. Në vijim, Bashkia Divjakë do të fokusohet në rritjen e transparencës dhe analizës së kostos për njësi, në mënyrë që rritja e shpenzimeve të shoqërohet me rritje të matshme të rezultateve (si mbrojtja e fondit pyjor, ulja e degradimit dhe rritja e inspektimeve). Kjo do të ndihmonte në përmirësimin real të efijencës buxhetore dhe jo vetëm në rritje nominale të shpenzimeve.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	ha		640.9	640.9	640.9	640.9	640.9
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	ha		640.9	640.9	640.9	640.9	640.9
Shpenzime për menaxhimin e fondit pyjor në lekë	lekë		796,129,000	1,351,310	212,860,012	200,367,529	227,554,828
Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor	numër		85	90	90	92	94
Aktivite të sensibilizuuese për mbrojtjen dhe rëndesinë e pyjeve	numër		5	5	6	8	10
Numri i punonjësve të administrimit të pyjeve të trajnuar	numër		4	4	5	5	5



Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.


Shpenzime per menaxhimin e fondit pyjor në lekë

Në Bashkinë Divjakë, shpenzimet për menaxhimin e fondit pyjor kanë shënuar një rritje shumë të fortë gjatë periudhës 2021–2025, me disa luhate ndër vite. Në vitet 2021 dhe 2022, shpenzimet janë relativisht të ulëta, përkatësisht 796,129 lekë dhe 1,351,310 lekë, duke reflektuar një fazë me ndërhyrje të kufizuara. Nga viti 2023 vihet re një rritje shumë e madhe në 212,860,012 lekë, çka tregon zgjerim të ndjeshëm të aktivitetit dhe financimit për këtë sektor. Në vitin 2024 ka një ulje të lehtë në 200,367,529 lekë, ndërsa në vitin 2025 shpenzimet rriten përsëri në 227,554,828 lekë, duke treguar rforcim të investimeve dhe angazhimit në menaxhimin e fondit pyjor. Në përgjithësi, trendi tregon rritje të konsiderueshme të financimit dhe intensifikim të punës në këtë sektor në Bashkinë Divjakë, me nevojë për vazhdimësi dhe menaxhim sa më efikas të fondeve.



Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor

Në Bashkinë Divjakë, numri i kontrolleve dhe inspektimeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqet një trend të qëndrueshëm në rritje të lehtë gjatë periudhës 2021–2025. Në vitin 2021 janë realizuar 85 kontrolle, ndërsa në vitin 2022 ky numër rritet në 90, duke treguar forcim të monitorimit në terren. Në vitin 2023 niveli mbetet i pandryshuar në 90, ndërsa në vitin 2024 rritet lehtë në 92 dhe në vitin 2025 arrin në 94 kontrolle. Në përgjithësi, kjo ecuri tregon një përmirësim gradual dhe stabil të sistemit të inspektimeve, duke reflektuar rritje të kapaciteteve monitoruese dhe vëmendje më të madhe ndaj menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor në Bashkinë Divjakë.





Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Funksioni i menaxhimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi iu transferua Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 2016. Në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, deri në fund të vitit 2018 u ngritën stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, secili me një strukturë minimale prej 14 punonjësish. Analiza e këtij shërbimi mbështetet kryesisht në dy tregues kryesorë: numrin e zjarrfikësve për çdo 1.500 banorë dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10.000 banorë. Në nivel kombëtar, raporti aktual është afërsisht një zjarrfikës për 1.500 banorë. Një tendencë e ngjashme vërehet edhe në aspektin e mjeteve zjarrfikëse, ku disponueshmëria e tyre bie në raport me rritjen e madhësisë së bashkive. Bashkia është përgjegjëse për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës	Zjarrfikës të trajnuar/zjarrfikës total (në %)	100	100	100	100	100	100
Stacione MZSH	Numri i stacioneve MZSH	1	1	1	1	1	1
Eficienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH	Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë	0	11,433,000	13,276,000	16,193,000	16,766,000	18,650,000
Përmirësimi i shërbimit ndaj komunitetit	Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit (ndryshimi vjetor në numër)	0	180	155	187	142	137
Numri i banorëve për zjarrfikës	Raporti i numrit të banorëve ndaj numrit të zjarrfikësve (banorë për 1 zjarrfikës)	0	3,922.57	4,000.21	4,000.21	4,000.21	4,000.21
Kapacitet financiare nga burimet e veta për mbulimin e shërbimit	Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %)	0	1.87%	1.62%	1.37%	2.02%	1.50%



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zjarrfikës në dispozicion	numër		14	14	15	15	15
Total shpenzime për mzsh (në lekë)	lekë		12,579,000	16,859,000	28,266,000	31,545,000	39,804,000
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	numër		14	14	15	15	15
Numri total i popullsisë	numër		54,916	56,003	32,800	32,800	32,800
Numri i stacioneve MSZH	numër		1	1	1	1	1
Numri i punonjesve te MZSH Meshkuj	numër		14	14	15	15	15
Të ardhura nga tarifatat për shërbimet shtesë nga zjarrfikësja (në lekë)	lekë		160,000	160,000	223,000	340,000	280,000
Zjarrfikës të trajnuar	numër			14	12	12	12
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH	numër		124	124	186	142	132
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatarja ditën dhe natën)	në sekonda		50	50	60	60	60
Inspektime tek të tretët	numër		17	17	28	39	20



Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.


Total shpenzime për mzsh (në lekë)

Në Bashkinë Divjakë, totali i shpenzimeve për MZSH (Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi) paraqet një trend të qëndrueshëm rritës gjatë periudhës 2021–2025. Në vitin 2021 shpenzimet janë 12,579,000 lekë, ndërsa në vitin 2022 rriten në 16,859,000 lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 34%. Ky trend vijon edhe në vitin 2023, ku shpenzimet arrijnë në 28,266,000 lekë (+67% krahasuar me 2022), duke reflektuar rritje të angazhimit dhe nevojës për forcim të kapaciteteve të shërbimit. Në vitin 2024 shpenzimet rriten më tej në 31,545,000 lekë, ndërsa në vitin 2025 arrijnë në 39,804,000 lekë, duke treguar konsolidim të vazhdueshëm të investimeve në këtë sektor. Në përgjithësi, kjo ecuri tregon përmirësim të vazhdueshëm të financimit për shërbimin MZSH në Bashkinë Divjakë, që lidhet me rritjen e gatishmërisë operacionale dhe përmirësimin e sigurisë ndaj emergjencave.




Të ardhura nga tarifat për shërbimet shtesë nga zjarrfikësja (në lekë)

Në Bashkinë Divjakë, të ardhurat nga tarifat për shërbimet shtesë të zjarrfikësës paraqesin një trend me rritje të përgjithshme, por me një luhetje në vitin e fundit. Në vitet 2021 dhe 2022 të ardhurat mbeten të pandryshuara në nivelin 160,000 lekë. Në vitin 2023 vihet re një rritje në 223,000 lekë (+39%), ndërsa në vitin 2024 arrijnë kulmin në 340,000 lekë (+52%). Kjo tregon rritje të kërkesës për shërbime shtesë dhe përmirësim të mbledhjes së të ardhurave. Në vitin 2025 ka një rënie në 280,000 lekë (-17.6% krahasuar me 2024), e cila mund të lidhet me ulje të kërkesës për shërbime ose me më pak ndërhyrje të jashtme që gjenerojnë tarifa. Në përgjithësi, tendenca mbetet pozitive gjatë periudhës, duke reflektuar rritje të rolit dhe funksionimit financiar të shërbimit zjarrfikës në Bashkinë Divjakë, me nevojë për stabilizim të të ardhurave në vitet në vijim.



Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH

Në Bashkinë Divjakë, numri i rasteve të menaxhuara nga shërbimi MZSH për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimit paraqet luhatje gjatë periudhës 2021–2025. Në vitet 2021 dhe 2022, numri i rasteve mbetet i njëjtë në 124, duke treguar një nivel të qëndrueshëm të ndërhyrjeve. Në vitin 2023 vihet re një rritje e ndjeshme në 186 raste (+50%), që mund të lidhet me shtim të incidenteve apo me rritje të raportimit dhe kapacitetit të ndërhyrjes. Në vitin 2024 rastet ulen në 142 (-23.7% krahasuar me 2023), ndërsa në vitin 2025 vijon një ulje e lehtë në 132 raste (-7%). Kjo mund të tregojë përmirësim të masave parandaluese ose kushte më të favorshme krahasuar me vitin e mëparshëm. Në përgjithësi, dinamika tregon një vit me kulm të ngarkesës (2023), i ndjekur nga stabilizim gradual i situatës në Bashkinë Divjakë, duke reflektuar edhe efektin e masave parandaluese dhe përmirësimit të menaxhimit të emergjencave.





Menaxhimi i mbetjeve

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, bashkitë kanë detyrimin për administrim, mbikëqyrjen, inspektimin, organizimin ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; administrimin e granteve, huave ose financimeve për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; pastrimin e rrugëve, parqeveve etj. Ky funksion përfaqëson një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të bashkisë, me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve.





Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen rurale	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen rurale kundrejt totalit të popullatës rurale (në %)	0	90.03	89.7	95	95	96
Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Raporti në % i popullsisë së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj popullsisë totale të bashkisë	0	91.41	91.07	95	95	96
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen urbane	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen urbane kundrejt totalit të popullatës urbane (në %)	0	95.21	94.89	100	100	100
Depozitimi I mbetjeve ne vende me leje mjedisore	Verifiko nese bashkia depoziton ne vende me leje mjedisore (PO = 1 ose JO = 0)	0	0	0	0	0	0
Rritja e territorit të mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	0	93.68	96.91	95	95	95




Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- **Rritja e territorit të mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve**

Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë

Në Bashkinë Divjakë, mbulimi i territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve paraqet një nivel shumë të lartë dhe përgjithësisht të qëndrueshëm gjatë periudhës 2021–2025. Në vitin 2021, mbulimi është 93.68%, ndërsa në vitin 2022 rritet në 96.91%, duke treguar përmirësim të dukshëm të shërbimit dhe zgjerim të territorit të përfshirë. Në vitin 2023 vihet re një stabilizim në 95%, nivel që ruhet edhe në vitet 2024 dhe 2025. Në përgjithësi, kjo tregon se Bashkia Divjakë ka arritur një mbulim pothuajse universal të territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, duke ruajtur një standard të qëndrueshëm dhe të lartë gjatë viteve të fundit. Sfida kryesore mbetet ruajtja e cilësisë së shërbimit dhe përmirësimi i mëtejshëm i eficiencës operative.





Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2021	2022	2023	2024	2025
Sipërfaqja gjithësej e bashkisë	km2	309.58	309.58	309.58	309.58	309.58
Numri i stafit i angazhuar pr shërbimin	numër	6	9	9	12	12
Depozitimi i mbetjeve ne vende me leje mjedisore (verifiko PO = 1, JO= 0)	numër	1	1	0	0	0
Numri i përgjithshëm i popullsisë në zonën rurale	numër	40,211	41,249	41,374	41,501	41,511
Numri i popullsisë në zonën urbane	numër	14,705	14,754	14,854	14,900	14,909
Siperfaqe e pastruar (ne m2)	m2	935	1,320	1,400	1,450	1,500
Sasia totale e mbetjeve urbane	ton	4,365	4,630	4,048	5,660	5,992
Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	50,200	51,000	56,228	56,401	56,420
Numri i popullsisë në zonen rurale e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	36,200	37,000	38,900	39,100	39,200
